



Lehtësimi për Përafrim me Acquis të BE-s

Mbështetje e mëtutjeshme zhvillimit të tregtisë në Kosovë

Nr. Identifikues i Projektit

EuropeAid/138565/DH/SER/XK

Kontratë Shërbimi Nr. 2018/395-320

RAPORTI VJETOR PËR SHËRBIME DHE TREGTINË E SHËRBIMEVE 2019

Qershor 2020



Kontakt personat tuaj në
GFA Consulting Group GmbH janë

Z-sha Martina Bernauer (Drejtoreshë Projekti)
Z. Luis Abugattas (Udhëheqës Ekipi)

Kosovë

Mbështetje e mëtutjeshme zhvillimit të tregtisë në Kosovë
Numri i Kontratës 2018/395-320

Raport

Akt. nr. 2.8.8 – Raporti vjetor për shërbime dhe tregtinë e shërbimeve 2019

Autorët

Znj. Shqipe Jashari Sekiraqa
Z. Mirsad Simnica
Z. Artur Rexhaj

Originali është shkruar në gjuhën angleze

Qershor 2020

Mohim

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe GFA Consulting Group GmbH dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian

GFA Consulting Group GmbH

Eulenkrugstr. 82
D-22359 Hamburg
Gjermani

Tel: +49 (40) 6 03 06 170

Fax: +49 (40) 6 03 06 159

E-mail: Mareike.meyn@gfa-group.de

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Tregtia e Shërbimeve të Kosovës: Zhvillimet Aktuale Legjislative dhe të Politikave	5
3. Struktura e Sektorit të Shërbimeve të Kosovës	7
3.1. Shërbimet në PBB	7
3.2. Punësimi në Veprimtaritë e Shërbimeve	9
3.3. Bizneset e Reja të Regjistruara në Shërbime.....	10
4. Tregtia e Shërbimeve të Kosovës	11
4.1 Pasqyra e Tregtisë	11
4.2 Tregtia e shërbimeve sipas sektorëve kryesor	13
4.2.1 Udhëtimi	13
4.2.2 Transporti	14
4.2.3 Shërbimet Afariste	15
4.2.4 Shërbimet Qeveritare	20
4.2.5 Shërbimet personale, kulturore dhe rekreative	20
5. Komentet Përmbyllëse	22

1. Hyrje

Sektori i shërbimeve është segmenti më i madh i ekonomisë së Kosovës dhe forca e saj shtytëse, i cili kontribuon një pjesë të madhe në vlerën e shtuar, punësim dhe në tregtinë vendore. Veprimtaritë e shërbimeve përbënin 74 përqind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në vitin 2018 në çmime bazike dhe punësuan 85.2 përqind të forcës së përgjithshme punëtore në Kosovë në vitin 2019. Veprimtaritë e shërbimeve përbëjnë 83.4 përqind të bizneseve të reja të regjistruara në vitin 2019.¹

Me kalimin e kohës, pesha relative e shërbimeve në ekonominë e vendit është rritur gradualisht, dhe zhvendosja në tregtinë e shërbimeve, përbën elementin kyç për të integruar Kosovën në ekonominë globale. Ndryshe nga tregtia e mallrave, ku Kosova pëson deficit tregtar mesatarisht 40 përqind të PBB-s, tregtia e shërbimeve paraqet një situatë krejtësisht ndryshe. Në vitin 2019, tregtia e shërbimeve regjistroi një suficit tregtar prej 932 milion, i cili kontribuoi në PBB me 13.3 përqind. Pasi tregtia e shërbimeve është kontribues kryesor për të ndihmuar financimin e llogarisë rrjedhëse të Bilancit të Pagesave (BiP), duhen bërë përpjekje të mëtejshme nga politikë bërësit që të zhvendoset vëmendja dhe t'i jepet prioritet më i lartë tregtisë së shërbimeve, e cila do të kontribuonte mjaft në përmirësimin e aspiratave zhvillimore të Kosovës.

Sipas Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), Marrëveshja e Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve (GATS), e cila miratoi përkufizimin e tregtisë së shërbimeve. Tregtia e shërbimeve zhvillohet përmes katër mënyrave të ofertës. Ky përkufizim konsensual është përfshirë edhe në Protokollin Shtesë 6 të Marrëveshjes së CEFTA-s.

Ky dokument përfshin vetëm tri nga katër mënyrat e ofertës, të identifikuar në GATS.² Në mënyrë që tregtia të shqyrtohet nën Mënyrën 1, ajo duhet të jetë ofertë ndërkuftare, që do të thotë se Mënyra 1 përfshin flukset e shërbimeve nga territori i një Anëtari në territorin e një Anëtari tjetër (shërbimet e telekomunikacionit, transportit dhe ato postare dhe ndërlidhëse). Mënyra 2 e ofertës përfshin konsumin jashtë vendit dhe i referohet situatave, ku një konsumator shërbimesh lëviz në territorin e një Anëtari tjetër për të pranuar shërbime (shërbimet e udhëtimit, shëndetësore dhe arsimore). Mënyra 3 e ofertës bazohet në praninë komerciale dhe ajo nënkupton se një ofrues i shërbimeve nga një vend anëtar themelon prani territoriale përmes pronësisë ose dhënies me qira të lokaleve në territorin e një anëtari tjetër (kompanitë e huaja të sigurimit, bankat, zinxhirët e hoteleve, filialet vendore). Tregtia e shërbimeve nën Mënyrën 3 duhet të vlerësohet si Tregtia e Shërbimeve e Filialeve të Huaja (FATS) dhe mënyra 3 nuk pasqyrohet në bilancin e pagesave, sepse këto të dhëna nuk janë të disponueshme në rastin e Kosovës. Pjesa më e madhe e tregtisë në tërë botën zhvillohet përmes mënyrës 3 të ofertës. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të FATS-it duhet të jete me rëndësi të lartë në përpjekjet e ardhshme, që synojnë përmirësimin e të dhënave të tregtisë së shërbimeve në Kosovë, duke e ditur se kjo mënyrë e ofertës mbizotëron në rastin e shërbimeve financiare në Kosovë. Mënyra e ofertës së shërbimeve zhvillohet me praninë e personave fizik dhe përbëhet nga personat e një Anëtari që hyn në territorin e një Anëtari tjetër për të ofruar një shërbim (shërbimet ndërtimore, shërbimet tjera afariste, p.sh. kontabilistët, mjekët, mësime të ndërtimit). Shtojca e GATS-it për Lëvizjen e Personave Fizik saktëson se vendet janë të lira të zbatojnë masa lidhur me vendbanimin, shtetësinë ose qasjen në tregun e punësimit në baza të përhershme.

Është me rëndësi të theksohet se ky dokument shërben si një raport vjetor i shërbimeve dhe zhvillimit në Kosovë dhe duhet të trajtohet si i tillë. Ky dokument shqyrton strukturën dhe performancën e shërbimeve në ekonominë dhe tregtinë e Kosovës, duke synuar që të jap disa perceptime, të cilat mund të ndihmojnë në formulimin e politikave të ardhshme për t'u mundësuar veprimtarive të shërbimeve të kontribuojnë më mirë në rritjen ekonomike të Kosovës. Duke e ditur natyrën e këtij dokumenti, kjo analize mbulon vetëm vitet 2017, 2018 dhe 2019. Studimi i tanishëm nuk synon të jap një këndvështrim më të gjerë të faktorëve mbështetës, që shpjegojnë zhvillimin e tregtisë së shërbimeve të Kosovës. Ky raport më tepër përqendrohet në njohjen më të mirë të tendencave aktuale në tregtinë e shërbimeve të Kosovës.

¹ Të dhënat u siguruan nga Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve

² Katër mënyra të ofertës së GATS/OBT

Dokumenti është ndërtuar si më poshtë. Pjesa e radhës shqyrton zhvillimet e reja të politikës që janë ndërmarrë në përpjekje për të shtuar rolin e veprimtarive të shërbimeve në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Pjesa tre shqyrton strukturën dhe performancën e sektorit të shërbimeve në ekonominë e Kosovës. Pjesa katër paraqet një pasqyrë të tregtisë së shërbimeve të Kosovës. Analiza fokusohet në pesë sektorët kryesorë duke përfshirë shërbimet e udhëtimit, transportit, shërbimet afariste, shërbimet personale, kulturore dhe rekreative dhe shërbimet qeveritare. Ky raport nuk shqyrton drejtimin e tregtisë së shërbimeve të Kosovës, por përqendrohet në identifikimin e kategorive në tregtinë e shërbimeve që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

2. Tregtia e Shërbimeve të Kosovës: Zhvillimet Aktuale Legjislative dhe të Politikave

Në rastin e Kosovës, mjedisi rregullator në tregtinë e shërbimeve përbëhet nga dy organe ndërlidhëse të instrumenteve juridike, sipas të cilave zbatohen rregullat e veçanta lidhur me themelimin dhe funksionimin e tregtisë së shërbimeve. Legjislacioni vendas që bën përpilimin e të gjitha ligjeve horizontale, të cilat zbatohen për veprimtaritë e shërbimeve në Kosovë dhe disa legjislacione të veçanta sektoriale, të cilat rregullojnë sektorët specifik. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka ndërmarrë përpilimin e të gjitha ligjeve dhe procedurave administrative vendore, të cilat rregullojnë ofrimin e veprimtarive të shërbimeve. Sa i përket zotimeve sektoriale, kjo e fundit i referohet kryesisht zotimeve ndërkombëtare, të miratuara nga Kosova në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA)³ dhe Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore për (CEFTA) për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve.

MSA-ja përfshin në agjendën e saj dispozita të rëndësishme lidhur me tregtinë e shërbimeve. Në Titullin V për “Themelimin, Ofrimin e Shërbimeve dhe Kapitalin”, Neni 51 thekson parimet e mos diskriminimit, barazisë dhe trajtimit kombëtar, të cilët janë komponentë thelbësorë për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve. Barazia sa i përket personave fizik parashikohet në Nenin 55, paragrafi 2, i cili thotë se personeli kryesor i një kompanie të huaj mund të jenë shtetasë nga vendi i origjinës së kompanisë, duke iu mundësuar qytetarëve kosovar qasje në tregjet e BE-s dhe të huajve të punojnë me lehtësi në njësi të huaja në Kosovë. Këta individë do të lejohen të banojnë në territorin e palës tjetër në përputhje me ligjet përkatëse vendase. Për më tepër, Neni 56 cekë se brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, do të shqyrtohet njohja reciproke e kualifikimeve për të lehtësuar liberalizimin e tregtisë. Vlerësimi nuk ka përfunduar ende. Në fund, Neni 58 thotë se do të merren hapa në linjë me procesin e liberalizimit dhe në përputhje me paragrafin 1, 2 dhe 3, që të mundësohet ofrimi i shërbimeve nga kompanitë e BE-s dhe të Kosovës ose të qytetarëve të tyre në territorin e një pale të huaj. Palët do të lejojnë lëvizjen e përkohshme të personave fizik, që e ofrojnë shërbimin ose të cilët janë të punësuar nga ofruesi i shërbimeve. Neni 58 do të përfundohet pesë vite nga hyrja në fuqi.

Agjenda e MSA-s parashikon zbatim gradual të programit të saj në lehtësimin e tregtisë së shërbimeve. Palët tashmë kanë zbatuar disa nga zotimet, ndërsa për të tjerat, siç është eliminimi i pengesave për të udhëtuar lirshëm mbetet të bëjnë më shumë përparim. Lehtësimi i pengesave për individët që udhëtojnë përtej kufijve duhet të qëndrojë lartë në listën e prioriteteve për Kosovën dhe të inkorporohen në një program të përbashkët pune që synon zbatimin e zotimit të ardhshëm lidhur me tregtinë e shërbimeve.

Zotimi kryesor i miratuar nga Kosova në kuadër të MSA-s është se legjislacioni vendas i Kosovës për veprimtaritë e shërbimeve duhet të jetë në përputhje me atë të BE-s. Në këtë kuptim, është i rëndësishëm detyrimi për transpozim të Direktivës së Shërbimeve (DSH) të BE-s,⁴ i cili synon të lehtësojë themelimin dhe ofrimin e shërbimeve brenda tregut të brendshëm të BE-s, duke ofruar shërbime ndërkombëtare midis shteteve anëtare të BE-s. Direktiva e Shërbimeve (DSH) të BE-s është transpozuar pjesërisht me miratimin e Ligjit të Shërbimeve në kornizën ligjore vendase në mars të vitit 2017. Ligji për Shërbime garanton të drejtën e themelimit, i cili rregullon hapjen e tregut dhe mbrojtjen e bizneseve vendase në Kosovë, ku përfshihen rreth 400 veprimtari të ndryshme shërbimesh. Në lidhje me zbatimin e Ligjit të Shërbimeve, janë identifikuar 54 instrumente ligjore vendore dhe udhëzime administrative që kërkojnë ndryshime me qëllim që Ligji i Shërbimeve të jetë në përputhje të plotë me Direktivën e Shërbimeve (DSH) të BE-s. Për më tepër, udhëzimi administrativ 05/2018 i miratuar më 23 mars, 2018 për procedurat e njoftimit dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së akteve normative me ligjin e shërbimeve siguron që secila

³ MSA-ja është marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, ajo do të vendosë një marrëdhënie kontraktuale që siguron të drejta reciproke midis dy palëve. MSA-ja do të mbështes integrimin ekonomik dhe politik të Kosovës në Bashkimin Evropian. Marrëveshja MSA u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës në nëntor të vitit 2015 dhe hyri në fuqi në prill, 2016.

⁴ Kosova synon të jetë shtet anëtar i BE-s në të ardhmen e afërt, legjislacioni i saj i brendshëm duhet të jetë në përputhje me atë të BE-s. Përveç kësaj, duke respektuar Direktivën e Shërbimeve të BE-s, Kosova do ta ketë më të lehtë të tregtojë me BE-n dhe potencialisht të autorizohet për tregtinë e shërbimeve me shtetet anëtare të BE-s, në përputhje me Kapitullin III të Direktivës së BE 2006/123/EC.

rregullore të jetë në përputhje me dispozitën e Ligjit. Ligji për Shërbime kërkon që të krijohet një Pikë e Vetme e Kontaktit (PVK) brenda kornizës së Direktivës së Shërbimeve (DSH) të BE-s dhe CEFTA-s. Në lidhje me këtë është miratuar udhëzimi administrativ 04/2018 për mënyrën e funksionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK), e cila rregullon funksionalitetin e një platforme elektronike shumë funksionale për shërbime, qëllimi i së cilës është të lehtësohet qasja e ofruesve të shërbimeve në tregun e shërbimeve të Kosovës. Departamenti i Tregtisë i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i ndihmuar nga projekti i Bashkimit Evropian “Mbështetje e Mëtejshme Zhvillimit të Tregtisë në Kosovë (EUTSP)” ka propozuar një program pune për ta kryer këtë detyrë”.

Në rastin e CEFTA-s, lehtësimi i tregtisë së shërbimeve është përfshirë në marrëveshjen midis anëtarëve të saj, e cila ka ndër objektivat e saj, liberalizimin gradual dhe bashkëpunimin e ndërsjellë të tregjeve. Niveli i lartë i liberalizimit duhet të jetë në përputhje me Nenin V të GATS-it (Neni 29). Zotimet e miratuara në përputhje me negociatat e tilla përcaktohen në planet që janë pjesë përbërëse e marrëveshjes (Neni 29). Për të zbatuar zotime të tilla dhe veprimtari tjera që lidhen me tregtinë e shërbimeve, në vitin 2015 është formuar Nën-Komiteti për Tregtinë e Shërbimeve.

Zotim shumë i rëndësishëm i miratuar nga Qeveria e Kosovës në kuadër të CEFTA-s ka qenë Protokollin Shtesë 6 për Tregtinë e Shërbimeve (PSH 6) ku anëtarët e CEFTA-s synojnë liberalizimin e tregtisë në sektorë të të ndryshëm të shërbimeve. PSH 6 është miratuar nga palët e CEFTA-s në dhjetor të vitit 2019 dhe ai duhet të ndjekë procedurat e brendshme para miratimit të tij përfundimtar. Zbatimi efektiv i PSH 6 do të kontribuojë në rritjen e tregtisë ndër-rajonale të shërbimeve, krijimin e kushteve të favorshme për zhvillim ekonomik dhe sigurimin e informatave mbi kushtet në të cilat do të zhvillohet tregtia e shërbimeve. Qasja në dokumentet publike sa i përket tregtisë së shërbimeve do të garantohej nga krijimi i një Pike të Kontaktit për Shërbime (PKSH), në të cilën çdo pale pjesëmarrëse do t'i mundësohej qasja në të gjitha informatat dhe ndihma në mënyrë efikase për themelimin dhe funksionimin në Kosovë. Për më tepër, një platformë e vetme elektronike do të lehtësojë hyrjen në të gjitha dokumentet dhe procedurat e nevojshme për çdo subjekt publik dhe privat për të depërtuar në tregun vendor.

Një zotim tjetër në kuadër të CEFTA-s me potencial të konsiderueshëm për të rritur tregtinë e shërbimeve ndërmjet BP 6 ka qenë përpjekja për arritje të një marrëveshjeje konsensuale për njohje të ndërsjellë të kualifikimeve profesionale (NNKP). Kosova do të përfitonte shumë nga kjo marrëveshje duke e ditur se Bosnja & Hercegovina dhe Serbia nuk e njohin shtetësinë e saj. Deri në qershor të vitit 2019, janë mbajtur shtatë raunde të negociatave. Përkundër kësaj, negociatat janë pezulluar përkohësisht.

3. Struktura e Sektorit të Shërbimeve të Kosovës

3.1. Shërbimet në PBB

Kontributi i lartë i veprimtarive të shërbimeve në PBB është veçori të cilën zakonisht e ndajnë pjesa më e madhe e ekonomive në zhvillim. Kosova, ngjashëm me ekonomi të tjera të vogla, me resurse të pakta, tregon kontribut të lartë të shërbimeve në vlerën e përgjithshme të shtuar në ekonomi dhe pjesëmarrja e lartë e shërbimeve në PBB paraqet pamundësinë për të zhvilluar një bazë prodhuese. Në këtë drejtim, ekziston një lidhje e fortë midis rritjes së peshës relative të sektorit të shërbimeve dhe rritjes ekonomike.

Tabela 1 paraqet strukturën e sektorit të shërbimeve të Kosovës për periudhën 2017-2018. Është me rëndësi të theksohet se shifrat e zbërthyera për sektorin e shërbimeve për vitin 2019 ende nuk janë në dispozicion. Shifrat zyrtare, sipas Agjencisë së Statistikave në Kosovë, do të publikohen në shtator. Të dhënat e tregojnë PBB-n në çmime konstante, gjë e cila mundëson vlerësim më të mirë, pasi taksat dhe subvencionet tjera nuk mund t'i atribuohen sektorëve të ndryshëm. Në krahasim me vitin 2017, të dhënat në vitin 2018 qartë tregojnë zhvendosje graduale drejt sektorit të shërbimeve që në PBB-n totale fitoi 2.8 përqind. Në vitin 2018, në sektorët e shërbimeve, tregtia me pakicë dhe shumicë mbetet kontribuesi kryesor në PBB me 16 përqind, një rritje në kontribut me 0.7 përqind krahasuar me vitin 2017. Njëkohësisht, ndryshimi kryesor në krahasim me vitin 2017, është rritja relative e pjesëmarrjes së ndërtimit në PBB-n totale, e cila ka pësuar rritje të pjesëmarrjes së saj me 2.0 përqind. Është e dukshme rritja në kontributin e administratës publike, shpërndarja e se cilës është shërbim.

Tabela 1. Produkti i Brendshëm Bruto i Kosovës sipas veprimtarive ekonomike 2017-2018 në çmime konstante

Sektori	2017	% e totalit	2018	% e totalit	% ndryshim
<i>D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar</i>	217,122	4.3	223,043	4.2	-0.1
<i>E- Furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi dhe rehabilitimi i mbeturinave</i>	45,343	0.9	48,693	0.9	0.0
<i>F- Ndërtimi</i>	429,627	8.5	561,057	10.4	2.0
<i>G-Tregtia me pakicë dhe shumicë; riparimi i automjeteve dhe motorëve</i>	780,094	15.3	862,282	16.0	0.7
<i>H-Transportimi dhe ruajtja</i>	226,671	4.5	247,549	4.6	0.1
<i>I- Veprimtaritë e shërbimeve të akomodimit dhe ato ushqimore</i>	73,559	1.4	82,860	1.5	0.1
<i>J- Informimi dhe komunikimi</i>	115,358	2.3	121,803	2.3	0.0
<i>K-Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit</i>	230,992	4.5	232,645	4.3	-0.2
<i>L-Veprimtaritë e pasurive të paluajtshme</i>	496,492	9.8	502,635	9.4	-0.4
<i>M-Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike</i>	96,507	1.9	98,726	1.8	-0.1
<i>N- Veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe mbështetëse</i>	38,119	0.8	44,887	0.8	0.1
<i>O-Administrata publike me donatorë</i>	470,288	9.3	522,054	9.7	0.5
<i>P-Arsimi</i>	241,068	4.7	254,339	4.7	0.0
<i>Q-Veprimtaritë e shëndetit të njeriut dhe punës sociale</i>	113,864	2.2	124,876	2.3	0.1
<i>R-Artet, zbavitja dhe rekreacioni</i>	25,422	0.5	26,991	0.5	0.0
<i>S-Veprimtari të tjera shërbimi</i>	13,023	0.3	13,810	0.3	0.0
Shërbimet e përgjithshme dhe % në PBB	3,613,549	71.1	3,968,250	73.9	2.75
VBSH në çmime bazike	5,082,462		5,373,214		
Prodhimi i PBB-s me çmime konstante	6,326,641		6,658,434		

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

3.2. Punësimi në Veprimtaritë e Shërbimeve⁵

Tabela 2 në vijim paraqet shpërndarjen e punësimit në sektorin e shërbimeve për periudhën 2017-2019. Në total, veprimtaritë e shërbimeve përbëjnë 85.2 përqind të punësimit të përgjithshëm në ekonomi në vitin 2019, dhe në mënyrë të konsiderueshme, këto veprimtari kanë pësuar rritje në punësim, krahasuar me vitin 2017, me 3.7 përqind rritje në të gjitha vendet e reja të punës, të krijuara në sektorin e shërbimeve. Punësimi në veprimtaritë e shërbimeve përqendrohet në tregtinë me pakicë dhe shumicë, veprimtaritë e shërbimeve të akomodimit dhe ato ushqimore, veprimtaritë ndërtimore, profesionale, shkencore dhe teknike. Këto veprimtari të shërbimeve përbëjnë 58.6 përqind të punësimit të përgjithshëm në vitin 2019. Nën-sektori më dinamik sa i përket krijimit të punësimeve të reja gjatë periudhës 2017-2019 kanë qenë veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike, të cilat kanë pasur rritje në krijimin e punësimit me 8.2 përqind. Siç paraqitet në tabelë, tetë nën-sektorë të shërbimeve kanë pësuar rënie në krijimin e punësimit, që në veçanti vërehet në shërbimet ndërtimore, të cilat kanë ulur pjesëmarrjen e vet me 4.7 përqind.

Tabela 2. Punësimi i Kosovës në Sektorin e Shërbimeve {Mijëra dhe %}							
Sektori	2017	% e totalit	2018	2019	% e totalit	Pjesëmarrja % ndryshimi 2017-2019	Ndryshimi Absolut
<i>D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar</i>	95	0.5	91	45	0.2	-0.3	-50
<i>E - Furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi dhe rehabilitimi i mbeturinave</i>	372	2.1	84	112	0.6	-1.5	-260
<i>F - Ndërtimi</i>	2734	15.3	2123	1928	10.7	-4.7	-806
<i>G - Tregtia me pakicë dhe shumicë; riparimi i automjeteve dhe motorëve</i>	3796	21.3	3971	4027	22.3	1.0	231
<i>H - Transportimi dhe ruajtja</i>	524	2.9	444	508	2.8	-0.1	-16
<i>I - Veprimtaritë e shërbimeve të akomodimit dhe ato ushqimore</i>	1702	9.5	1776	2053	11.4	1.8	351
<i>J - Informimi dhe komunikimi</i>	999	5.6	1183	1113	6.2	0.6	114
<i>K - Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit</i>	488	2.7	122	104	0.6	-2.2	-384
<i>L - Veprimtaritë e pasurive të paluajtshme</i>	96	0.5	74	115	0.6	0.1	19
<i>M - Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike</i>	1077	6.0	1178	2573	14.2	8.2	1496
<i>N - Veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe mbështetëse</i>	810	4.5	918	914	5.1	0.5	104
<i>O - Administrata dhe mbrojtja publike, sigurimi i detyrueshëm social</i>	56	0.3	22	28	0.2	-0.2	-28
<i>P - Arsimi</i>	299	1.7	237	345	1.9	0.2	46
<i>Q - Veprimtaritë e shëndetit të njeriut dhe punës sociale</i>	422	2.4	343	363	2.0	-0.4	-59
<i>R - Artet, zbavitja dhe rekreacioni</i>	471	2.6	510	410	2.3	-0.4	-61
<i>S - Veprimtari të tjera shërbimi</i>	608	3.4	744	752	4.2	0.8	144
Punësimi total në shërbime	14549	81.5		15390	85.2		
Gjithsej	17846	100.0		18073	100.0		

⁵ Ky dokument përdor të dhëna preliminare për analizë. Vlerat në tabelë nuk janë version final dhe mund të ndryshojnë nga dokumentet zyrtare në Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve

3.3. Bizneset e Reja të Regjistruara në Shërbime

Tabela 3 në vijim tregon bizneset e reja të regjistruara në veprimtaritë e shërbimeve për periudhën 2017-2019. Në total, veprimtaritë e shërbimeve përbëjnë 83.4 përqind të bizneseve të reja të regjistruara në vitin 2019, duke përjetuar një rritje prej 2.0 përqind në bizneset e reja të regjistruara në krahasim me vitin 2017. Të dhënat në shtyllën e fundit të Tabelës 3 paraqesin nivele të ndryshme të hapjeve të bizneseve. Derisa disa sektorë paraqesin performancë mjaft pozitive në regjistrimin e bizneseve të reja, të tjerët mbesin prapa; duke treguar madje edhe rezultate negative. Sa i përket hapjeve të bizneseve, krahasuar me vitin 2017, nën-sektori më dinamik janë veprimtaritë e shërbimeve të akomodimit dhe ato ushqimore me 198 biznese të reja të regjistruara, të pasuara nga informimi dhe komunikimi me 173 hapje të bizneseve. Sektori i tregtisë me pakicë dhe shumicë mbetet sektori kryesor sa i përket bizneseve të reja të regjistruara me 2374 ndërmarrje të regjistruara në vitin 2019, megjithëse ka bilanc negativ të bizneseve të reja të regjistruara në krahasim me vitin 2017.


Tabela 3. Bizneset e Reja të Regjistruara në Shërbime (Mijëra dhe %)						
Sektori	2017	% e totalit	2018	2019	% e totalit	Ndryshimi absolut 2017-2019
<i>D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar</i>	41	0.4	40	27	0.3	-14
<i>E - Furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave</i>	37	0.4	42	34	0.3	-3
<i>F - Ndërtimi</i>	841	9.0	960	950	9.5	109
<i>G - Tregtia me pakicë dhe shumicë; riparimi i automjeteve dhe motorëve</i>	2486	26.7	2557	2374	23.7	-112
<i>H - Transportimi dhe ruajtja</i>	355	3.8	311	310	3.1	-45
<i>I - Veprimtaritë e shërbimeve të akomodimit dhe ato ushqimore</i>	943	10.1	1001	1141	11.4	198
<i>J - Informimi dhe komunikimi</i>	453	4.9	546	626	6.3	173
<i>K - Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit</i>	110	1.2	85	72	0.7	-38
<i>L - Veprimtaritë e pasurive të paluajtshme</i>	63	0.7	63	81	0.8	18
<i>M - Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike</i>	760	8.2	806	927	9.3	167
<i>N - Veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe mbështetëse</i>	417	4.5	467	560	5.6	143
<i>O - Administrata dhe mbrojtja publike, sigurimi i detyrueshëm social</i>	18	0.2	19	15	0.1	-3
<i>P - Arsimi</i>	110	1.2	134	148	1.5	38
<i>Q - Veprimtaritë e shëndetit të njeriut dhe punës sociale</i>	193	2.1	226	226	2.3	33
<i>R - Artet, zbavitja dhe rekreacioni</i>	232	2.5	274	243	2.4	11
<i>S - Veprimtari të tjera shërbimi</i>	518	5.6	662	620	6.2	102
% e Bizneseve të Reja të Regjistruara në Shërbime	7577	81.5		8354	83.4	777
Gjithsej Biznese të Reja të Regjistruara në Shërbime	9301			10014		

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

4. Tregtia e Shërbimeve të Kosovës⁶

4.1 Pasqyra e Tregtisë⁷

Figura 1 paraqet të dhënat e grupuara të Kosovës për tregtinë e shërbimeve për periudhën 2017-2019 sipas kategorive kryesore të shërbimeve. Tregtia e shërbimeve ka treguar progres gjatë kësaj periudhe, në të cilën ka pasur suficit të qëndrueshëm tregtar, që paraqet tendencat historike edhe pse eksportet e shërbimeve janë rritur në një normë vjetore mesatare prej 11.07 përqind, më e ulët se importet e shërbimeve të cilat kanë pësuar rritje mesatare vjetore prej 18.31 përqind. Si pasojë, ka pasur një bilanc pozitiv në tregtinë e shërbimeve edhe pse me normë ngadalësuese. Megjithatë, bilanci pozitiv në tregtinë e shërbimeve është luhatur ndjeshëm nga viti në vit. Është me rëndësi të theksohet se ruajtja e bilancit pozitiv në tregtinë e shërbimeve jep kontribut të rëndësishëm në financimin e llogarisë rrjedhëse. Në nivelin e përgjithshëm, eksportet e shërbimeve janë rritur nga EUR 1.358 miliardë në vitin 2017 në EUR 1,676 miliardë në vitin 2019, ndërsa importet janë rritur prej EUR 531.5 milion në vitin 2017 në EUR 743.9 milion në vitin 2019.



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

⁶ Për përmbledhje të shkurtër të tregtisë së shërbimeve, është përdorur përkufizimi i shërbimeve të OBT-s. Disa prej kategorive të përfshira në shërbime për qëllime të Bilancit të Pagesave shkrihen së bashku ose plotësisht lihen anash për shkak të parëndësisë së tyre në dokument.

⁷ Në këtë dokument nuk është përfshirë tregtia e "shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit", "detyrimet për shfrytëzim të pronësisë intelektuale" dhe "shërbimet prodhuese për inputet fizike në pronësi të tjerëve".

Eksporti i shërbimeve kryesore të Kosovës është udhëtimi. Udhëtimi ka përfaqësuar pjesën më të madhe të eksporteve gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2019, udhëtimi përfaqësonte 78.8 përqind të eksporteve të përgjithshme të shërbimeve, gjë që shpjegon faktin se shërbimet e udhëtimit përbëjnë suficitin që Kosova e regjistroi në tregtinë e shërbimeve. Krahasuar me vitin 2017, shërbimet e tjera afariste kanë përjetuar rritje të konsiderueshme në eksporte prej 88.8 milion më EUR 121.7 milion në vitin 2019, të pasuara nga shërbimet e telekomunikacionit, kompjuterike dhe të informacionit me EUR 68.1 milion eksporte në vitin 2019. Ka pasur rënie të ndjeshme në vlerën e eksporteve të shërbimeve qeveritare kryesisht për shkak të uljes së madhësisë dhe veprimtarive të subjekteve të huaja, siç është në mes tjerash KFOR-i, EULEX-i, në territorin e Kosovës. Sa i përket importeve, importet e shërbimeve kanë përjetuar normë më të lartë të rritjes se eksportet. Importet e shërbimeve janë më pak të përqendruara se eksportet, mirëpo, udhëtimi përbën importin kryesor. Vlen të theksohet se gjatë periudhës së analizës, shërbimet e transportit kanë rritur ndjeshëm nivelin e importeve.

4.2 Tregtia e shërbimeve sipas sektorëve kryesor

Kjo pjesë paraqet një vlerësim më të detajuar të tregtisë së shërbimeve të Kosovës. Ajo analizon tregtinë sipas llojit të shërbimeve dhe në nivel më të zërthyer, ajo shqyrton ecurinë e veprimtarive kryesore në secilën kategori.

Tabela 4. Tregtia e shërbimeve të Kosovës sipas sektorëve kryesor															
Viti	Udhëtimi			Transporti			Shërbimet Afariste			Mallrat dhe shërbimet qeveritare			Shërbimet personale, kulturore dhe rekreative		
	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci
2017	1112	235	877	37	119	-82	165	157	8	36	12	24	2.7	1.5	1.2
2018	1228	302	926	60	128	-68	232	243	-11	36	22	14	3.7	2.1	1.5
2019	1321	328	994	67	146	-79	245	230	15	33	23	10	6.2	4.7	1.5


Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Tabela 4 paraqet të dhënat e grupuara të tregtisë së shërbimeve të Kosovës për periudhën 2017-2019 sipas kategorive kryesore të shërbimeve. Mesatarisht, duhet cekur se norma e rritjes së eksportit është akoma stabile, me normë ngadalësuese krahasuar me importet. Në aspektin relativ, shërbimet e transportit kanë pësuar rritje më të madhe në eksporte me 81 përqind. Në përgjithësi, sektorët kryesor të shërbimeve paraqesin 90% përqind të tregtisë totale në vitin 2019. Është e rëndësishme të theksohet se shërbimet e udhëtimit përbëjnë shërbimet kryesore të eksportit dhe importit gjatë periudhës së analizës. Shërbimet e transportit mbeten sektori i vetëm i cili pësoi deficit tregtar për periudhën 2017-2019.

Përbërja e tregtisë në këto shërbime kërkon analizë të mëtejme. Në nivel më të zërthyer, kjo pjese do të zgjerojë analizën, duke shqyrtuar nën-kategoritë kryesore në secilin sektor.

4.2.1 Udhëtimi

Udhëtimi shënon shpenzimet e jo rezidentëve derisa janë në Kosovë dhe ato të udhëtarëve të përkohshëm të Kosovës kur janë në vendet e jashtme. Njerëzit udhëtojnë për qëllime të biznesit ose për ato personale. Sa i përket udhëtimeve personale, udhëtimi llogarit shpenzimet për qëllime shëndetësore ose arsimore dhe kryesisht për turizëm. Siç është cekur tashmë, udhëtimi është komponenti më i rëndësishëm i tregtisë së shërbimeve për Kosovën. Figura 2 paraqet tregtinë e shërbimeve të udhëtimit sipas nën-sektorëve kryesor për periudhën 2017-2019. Kategoria 'të tjera' paraqet udhëtimin për qëllime të tjera personale, përfshirë turizmin. Udhëtimi për arsye të tjera personale përbën pjesën dërrmuese të tregtisë së Kosovës lidhur me këtë llogari. Në rastin e Kosovës, udhëtimi personal, përveç biznesit, gjeneron një suficit dërrmues tregtar në këtë sektor. Kjo kategori paraqet kryesisht vizitorët që vijnë nga vendet me një numër të konsiderueshëm të diasporës kosovare. Siç mund të vërehet, eksportet dhe importet e udhëtimit personal kanë treguar dinamizëm në periudhën e shqyrtimit, gjatë së cilës udhëtimi personal ka shënuar suficit të qëndrueshëm dhe rritje të tregtisë. Në vitin 2019, eksportet e udhëtimit për arsye të tjera personale arritën në EUR 1,274 milion, duke përjetuar rritje prej 7.5 përqind në eksporte, në krahasim me vitin e shkuar. Në anën tjetër, shpenzimet për udhëtim personal të shtetasve të Kosovës jashtë vendit janë rritur nga EUR 261 milion në vitin 2018 në EUR 278 milion në vitin 2019. Eksportet e udhëtimit personal janë në rritje me një normë mesatare vjetore prej 7.8 përqind, ndërsa importet me normë prej 17.31 përqind.



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës


Udhëtimet afariste paraqesin një pjesë të vogël të shërbimeve totale edhe pse ato kanë pësuar rritje graduale viteve të fundit. Në vitin 2019, eksportet e udhëtimeve afariste janë rritur në EUR 32.4 milion. Rritja graduale në eksporte tregon se në Kosovë po vijnë më shumë njerëz, të cilët zhvillojnë veprimtari afariste. Po kështu, shpenzimet e shtetasve të Kosovës që udhëtuan për qëllime afariste në vitin 2019 ishin EUR 30 milion, një rënie e vogël në krahasim me vitin paraprak.

Në rastin e nën-sektorëve të tjerë, Kosova është një importues neto i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore. Sa i përket shërbimeve shëndetësore, gjatë vitit 2019 Kosova importoi EUR 9.6 milion, ndërsa eksportoi EUR 2.1 milion. Eksportet e shërbimeve shëndetësore arritën në EUR 13.2 milion në vitin 2019, duke pësuar suficit tregtar në shumën prej EUR 2.6 milion.

Ndikimi i diasporës në llogarinë e udhëtimit meriton një përpunim të mëtejshëm, pasi nuk është turizëm në kuptimin e vërtetë.

4.2.2 Transporti

Shërbimet e transportit lehtësojnë tregtinë ndërkombëtare dhe janë komponentë thelbësor në rritjen ekonomike të vendeve në zhvillim. Shkalla në të cilën një vend në zhvillim mund të integrohet më tej në tregtinë globale varet ndjeshëm nga cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve të transportit dhe logjistikës. Shërbimet dhe infrastruktura logjistike e dobët mund të jetë pengesë kryesore në realizimin e potencialit për tregti ndërkombëtare. Sa më i konsoliduar të jetë furnizimi i logjistikës, aq më e besueshme është shpërndarja nga pika e prodhimit tek konsumatori final.



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Shërbimet e transportit përbëhen nga katër nën-sektorë, përkatësisht shërbimet e transportit detar, transportit ajror, mënyrat e tjera të transportit dhe shërbimet postare dhe ndërlidhëse. Tri kategoritë e para përbëjnë lëvizjen e njerëzve dhe mallrave (ngarkesave). Përbërja e tregtisë në këto shërbime kryesisht bazohet në transportin ajror dhe mënyrat e tjera të transportit. Figura 3 paraqet tregtinë e shërbimeve të transportit sipas nën-sektorëve kryesor për 2017 deri 2019. Siç mund të vërehet, Kosova ka shënuar suficit në tregtinë e shërbimeve të transportit ajror gjatë periudhës së shqyrtimit. Mirëpo, suficiti tregtar po tregon një tendencë në rënie pasi norma e rritjes së importit ka qenë shumë më e lartë se norma e rritjes së eksportit. Tregtia e shërbimeve të transportit ajror mund të ndahet më tej në shërbimet e transportit të udhëtarëve, mallrave dhe shërbimeve të tjera. Në rastin e mallrave, transporti i tyre përmes ajrit, tregtia është e kufizuar, pothuajse inekzistente pasi pjesa më e madhe e tregtisë së Kosovës zhvillohet përmes tokës. Për transportin e udhëtarëve, Kosova varet kryesisht nga transportuesit e huaj, duke mos regjistruar eksportet e këtyre shërbimeve për periudhën nën shqyrtim pasi që nuk ka industri të zhvilluar ajrore. Në vitin 2019, importet e udhëtarëve përmes transportit ajror shënuan EUR 32 milion, një rritje prej 28 përqind në krahasim me vitin 2017. 'Të tjera' paraqet vetëm kategorinë e shërbimeve të transportit ajror, që kanë një suficit tregtar për shkak të pagesave të bëra nga transportuesit e huaj në Kosovë për shërbimet që lidhen me transportin ajror. Në vitin 2019, shërbimet e tjera të transportit ajror kanë treguar një tendencë në rritje, duke shënuar EUR 48 milion eksporte.

Mënyra të tjera të transportit përbëjnë shërbimet që ndihmojnë transportin dhe nuk parashikohen drejtpërdrejtë për lëvizjen e mallrave dhe personave.⁸ Këto mjete transporti përfshijnë transportin rrugor, transportin në rrugë ujore, transportin hekurudhor, të tubacionit, transportin hapësinor dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Në përgjithësi, importet e mënyrave të tjera të shërbimeve të transportit tejkaluan ndjeshëm eksportet, duke rezultuar në një deficit tregtar në rritje. Deficiti i vazhdueshëm tregtar tregon varësinë e lartë të tregtisë në furnizuesit e huaj të shërbimeve të transportit. Deficiti në tregti në këtë sektor kishte rënie të lehtë në EUR 84 milion në vitin 2019 nga EUR 87 milion në vitin 2017. Mënyra kryesore e transportit e regjistruar në Kosovë është transporti rrugor. Transporti rrugor mund të ndahet më tej në udhëtarë, mallra dhe të tjera. Transporti i ngarkesave, që është transporti i mallrave, përfaqëson 96.4 përqind të të gjitha importeve të këtyre shërbimeve. Në rastin e udhëtarëve, Kosova në vitin 2019 shënoi suficit në shumën prej EUR 13.3 milion, një rënie e lehtë në 6.3 pikë përqind në krahasim me vitin paraprak.

Në rastin e shërbimeve postare dhe ndërlidhëse, kjo kategori e shërbimeve mbetet e vogël, pasi ka vëllim të vogël të fluksit tregtar.

4.2.3 Shërbimet Afariste

Tregtia e shërbimeve afariste është segmenti me rritjen më të shpejtë në tregtinë e shërbimeve globale. Shtirja e shërbimeve afariste është ngritur aq sa rritja e sektorit të shërbimeve globale kryesisht nxitet nga rritja e shërbimeve afariste e jo nga shërbimet e konsumatorit. Kjo llogari regjistron eksportet dhe importet e një larmie të gjerë të veprimtarive të ndryshme, siç janë, në mes tjerash: shërbimet ndërtimore, shërbimet e tjera afariste, shërbimet e sigurimit dhe pensionale, shërbimet e telekomunikacionit dhe kompjuterike dhe ato financiare. Shërbimet afariste janë komponent i rëndësishëm i tregtisë globale të shërbimeve; prandaj, qeveria duhet të zhvendos vëmendjen dhe të forcojë më tej zhvillimin e këtij sektori në Kosovë. Tabela 5 paraqet zhvillimin e tregtisë së shërbimeve afariste të Kosovës për periudhën që analizohet. Tregtia e këtyre shërbimeve ka treguar dinamizëm të rëndësishëm, si në aspektin e eksporteve, ashtu edhe importeve. Eksportet totale po rriten me shpejtësi më të madhe se importet, duke rritur kështu suficitin tregtar të Kosovës. Eksportet u rritën me normë vjetore mesatare prej 14 përqind, ndërsa importet me 13.5 përqind.

⁸ Mënyrat tjera të transportit përfshijnë të gjitha mënyrat e transportit përveç atij detar dhe ajror.


Tabela 5. Tregtia e Shërbimeve Afariste sipas nën-sektorëve

Viti	Ndërtimi			Shërbimet tjera afariste			Shërbimet e sigurimit dhe pensionale			Shërbimet e telekomunikacionit, kompjuterike dhe informacionit			Shërbimet financiare		
	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci
2017	9.3	1.4	7.9	88.8	56.9	31.9	19.7	41.6	-21.9	46.6	51.3	-4.8	0.9	6.1	-5.2
2018	23.1	6.4	16.7	122.5	117.1	5.4	29.1	48.6	-19.5	55.8	61.1	-5.3	1.1	9.8	-8.7
2019	20.5	9.8	10.7	121.7	111.7	10.1	34.1	54.9	-20.8	68.1	48.1	20.0	0.5	5.6	-5.1

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Ndërtimi

Shërbimet ndërtimore janë kontribues i rëndësishëm në tregtinë globale të shërbimeve dhe kanë potencial të bëhen komponent thelbësor në tregtinë e shërbimeve të Kosovës. Shërbimet ndërtimore shënojnë ndërtimin jashtë vendit nga firmat kosovare dhe ndërtimin nga kompanitë e huaja në ekonominë raportuese. Figura 4 paraqet zhvillimin e tregtisë të shërbimeve ndërtimore sipas kategorive kryesore për periudhën 2017-2019. Eksportet e shërbimeve ndërtimore kanë pësuar rritje të theksuar që nga viti 2017, duke shënuar EUR 20.5 milion në vitin 2019. Kosova ka ruajtur suficitin në shërbimet ndërtimore gjatë kësaj periudhe dhe në vitin 2019 ka shënuar një suficit tregtar prej 10.7 milion. Shërbimet ndërtimore janë veprimtari e cila kërkon zhvillim të mëtutjeshëm.



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Shërbimet Tjera Afariste

Shërbimet tjera afariste janë në masë të madhe në mënyrën e 4 të ofertës, e cila kërkon praninë e personave fizik të një vendi në territorin e një vendi tjetër dhe njohjen e kualifikimeve personale. Shërbimet tjera afariste shënojnë eksporte dhe importe të tre shërbimeve të tregut: shërbimet e kërkimit dhe zhvillimit, shërbimet këshilluese profesionale dhe menaxhuese dhe shërbimet teknike dhe shërbimet që lidhen me tregtinë dhe shërbimet e tjera afariste. Për periudhën në fjalë, nuk ka të dhëna për kërkim dhe zhvillim të shërbimeve. Kjo kategori e shërbimeve është element i rëndësishëm në të ardhmen e tregtisë së shërbimeve, sepse ajo është mjet përmes të cilit teknologjia e avancuar përdoret për të ofruar avantazh konkurrues për sektorin e shërbimeve të Kosovës. Në përgjithësi, tregtia e shërbimeve të tjera afariste jep kontribut të rëndësishëm në tregtinë e përgjithshme të shërbimeve në Kosovë. Eksportet e këtyre shërbimeve janë në vendin e dytë për nga rëndësia në eksportet e shërbimeve në Kosovë. Në vitin 2019, shërbimet e tjera afariste shënuan EUR 121.7 milion në eksporte, ndërsa importet

ishin EUR 111.7 milion. Gjatë periudhës e cila shqyrtohet, importet totale u rritën me ritëm më të shpejtë se eksportet, duke ulur suficitin tregtar prej EUR 32 milion në vitin 2017 në EUR 10.1 milion në vitin 2019.

Tabela 6. Shërbimet Tjera Afariste sipas nën-sektorëve									
Viti	Shërbimet këshilluese profesionale dhe menaxhuese			Shërbimet teknike, shërbimet që lidhen me tregti dhe shërbimet e tjera afariste			Totali i Shërbimeve Tjera Afariste		
	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci
2017	24	12	11	65	44	21	89	57	32
2018	38	44	-6	85	73	12	123	117	5
2019	44	23	21	77	89	-11	122	112	10

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Në rastin e shërbimeve teknike, shërbimeve që lidhen me tregti dhe shërbimeve të tjera afariste, Kosova ka mundur të ruajë suficitin tregtar për dy vjet radhazi, 2017 dhe 2018, ndërsa në vitin 2019 ajo shënoi një deficit tregtar në shumë prej EUR 11 milion. Sidoqoftë, ecuria e eksporteve në këto shërbime, që shënuan EUR 77 milion në vitin 2019 nga EUR 65 milion në vitin 2017, është shenjë pozitive se rritja e këtyre shërbimeve mund të shënoj një vlerë të shtuar në tregtinë e përgjithshme të shërbimeve. Shërbimet këshilluese profesionale dhe menaxhuese kanë pasur rritje pozitive në eksporte që nga viti 2017, duke shënuar EUR 44 milion në vitin 2019. Në rastin e këtij nën-sektori, gjatë kësaj periudhe mund të vërehet një tendencë interesante. Deficiti tregtar në këtë kategori deri në vitin 2013 është kthyer dhe Kosova ia doli të arrijë suficitin tregtar ndërmjet viteve 2017 dhe 2019. Rritja graduale në suficitin tregtar mund të jetë tregues i mirë se është në fuqi zëvendësimi i importeve, ku ofruesit lokal të shërbimeve kanë mundur të depërtojnë në tregun e brendshëm.

Shërbimet e sigurimit dhe pensionale

Kjo llogari paraqet kryesisht tregtinë e shërbimeve të sigurimit, pasi nuk ka të dhëna për shërbimet pensionale. Shërbimet e sigurimit përfshijnë sigurimin e jo rezidentëve nga ndërmarrje të ndryshme vendase të sigurimeve dhe anasjelltas. Shërbimet e sigurimit dhe pensionale shënojnë shpenzimet në tri kategori të ndryshme, përfshirë në mesin e tyre, sigurimin e drejtpërdrejtë, i cili mbulon lloje të ndryshme të shërbimeve me jo rezidentët, siç janë sigurimi shëndetësor, jetësor ose i transportit. Risigurimi i kontraktuar me kompanitë e sigurimit për të bartur pjesë të portofoleve të tyre të riskut tek palët e tjera dhe shërbimet tjera ndihmëse të sigurimit, që ndër të tjera do të përfshijnë agjentët e sigurimit. Në rastin e shërbimeve ndihmëse të sigurimit, ky sektor mbetet i pazhvilluar, pasi nuk ka të dhëna të transaksioneve në këtë sektor gjatë periudhës së shqyrtimit.

Tabela 7. Shërbimet e Sigurimit dhe Pensionale sipas nën-sektorëve									
Viti	Totali i Shërbimeve të Sigurimit dhe ato Pensionale			Sigurimi i Drejtpërdrejtë			Risigurimi		
	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci
2017	19.7	41.6	-22	19.6	38.5	-18.9	0.1	3.1	-3.0
2018	29.1	48.6	-20	27.7	43.8	-16.1	1.4	4.8	-3.4
2019	34.1	54.9	-21	33.6	49.6	-16.0	0.5	5.3	-4.8

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Kosova është importues neto i shërbimeve të sigurimit, që tregon një deficit të qëndrueshëm tregtar gjatë periudhës së analizës. Në përgjithësi, ka pasur dinamizëm në eksporte dhe importe. Eksportet totale në vitin 2019 u rritën në EUR 34.1 milion, duke shënuar rritje në vlerë prej 73 përqind krahasuar me vitin 2017. Nga ana tjetër, importet u rritën nga EUR 41.6 milion në vitin 2017 në EUR 54.9 milion në vitin 2019.

Sigurimi i drejtpërdrejtë paraqet pjesën dërrmuese të tregtisë së shërbimeve të sigurimit të Kosovës, si në eksporte, ashtu edhe importe. Në vitin 2019, sigurimi i drejtpërdrejtë përbën 99 përqind të eksporteve totale të shërbimeve të sigurimit të Kosovës dhe 90 përqind të importeve totale. Në rastin e risigurimit, kjo kategori paraqet një pjesë të vogël të tregtisë së shërbimeve të sigurimit të Kosovës.

Shërbimet e telekomunikacionit, kompjuterike dhe të informacionit

Sektori i shërbimeve të telekomunikacionit, kompjuterike dhe të informacionit (TIK) është shfaqur si një sektor i rëndësishëm dhe në rritje në industrinë globale të shërbimeve. Padyshim se TIK-u ka shkuar përtej pozicionit të tij të mëparshme si një teknologji e kursimit të punës për t'u bërë qendër në të cilën inovacioni siguron shërbime efikase dhe cilësore. Me kalimin e viteve, tregtia e këtyre shërbimeve po zgjerohet me shpejtësi të madhe në Kosovë. TIK-u është kryesisht në mënyrën 1 të ofertës dhe përfshin transaksionet ndërkuftare. Shërbimet e TIK-ut përbëjnë tre nën-sektorë: shërbimet e telekomunikacionit, të cilat janë transmetimi i imazheve, të dhënave, tingujve dhe informacioneve përmes telefonit, radios, televizionit kabllovik dhe formave tjera të transmetimeve, përfshirë shërbimet e rrjetit të bizneseve, shërbimet e telekonferencës dhe të mbështetjes. Shërbimet kompjuterike, të cilat përbëhen nga shërbimet e përpunimit të të dhënave, shërbimet e postës elektronike dhe shërbimet që lidhen me harduer dhe softuer. Shërbimet e informacionit të cilat përfshijnë shërbimet e agjencive të lajmeve dhe shërbimet e tjera të informacionit, ku përfshihen fotografitë, artikujt e lajmeve dhe artikujt artistik për media dhe abonime të drejtpërdrejta jo të mëdha në gazeta.

Tabela 8. Shërbimet e telekomunikacionit, kompjuterike dhe të informacionit sipas nën-sektorëve												
Viti	Shërbimet e telekomunikacionit			Shërbimet kompjuterike			Shërbimet e Informacionit			TIK Total		
	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci
2017	31	40	-9	15	11	4	0.4	0.1	0.3	47	51	-5
2018	34	50	-16	21	11	11	0.5	0.2	0.2	56	61	-5
2019	34	35	-1	34	13	21	0.0	-	0.0	68	48	20

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Tabela 8 paraqet të dhënat e këtyre shërbimeve, të ndara sipas nën-sektorëve të saj kryesorë. Në përgjithësi, zhvillim interesant është përparimi që po tregon TIK-u viteve të fundit, si në aspektin e eksporteve, ashtu edhe importeve. Siç shihet gjatë periudhës së analizës, Kosova ka qenë në gjendje ta kthejë deficitin tregtar të cilin e ka pasur gjatë viteve 2017 dhe 2018 dhe në vitin 2019, ajo ka pasur suficit tregtar në shumën prej EUR 20 milion. Në rastin e shërbimeve të telekomunikacionit, është me rëndësi të theksohet se kjo llogari paraqet rezultatin e procesit të këmbimit të të ardhurave ndërmjet transportuesve të qarkullimit të telekomunikacionit ndërkombëtar dhe varet kryesisht nga niveli i qarkullimit hyrës dhe dalës. Rrjedha neto e qarkullimit do të përkthehet në rrjedhën e pagesës neto nga vendi i cili e 'eksporton' atë qarkullim. Shërbimet e telekomunikacionit janë nën-sektor mbizotërues në këto shërbime. Në vitin 2019, eksportet e këtyre shërbimeve përfaqësuan 50% të eksporteve totale në këtë llogari. Sa i përket importeve, ajo që bie në sy është rënia graduale e importeve nga EUR 50 milion në vitin 2018 në EUR 35 milion në vitin 2019.

Në rastin e shërbimeve kompjuterike, ky nën-sektor i shërbimeve është shfaqur si nën-sektor premtues, i cili vazhdimisht po zhvillohet. Shërbimet kompjuterike kanë treguar dinamizëm të konsiderueshëm sa i përket eksporteve, duke shënuar EUR 34 milion në vitin 2019 nga EUR 15 milion në vitin 2017. Suficiti i parë tregtar në shërbimet e telekomunikacionit, kompjuterike dhe të informacionit në vitin 2019 mund t'i atribuohet kryesisht rritjes graduale në eksportet e shërbimeve kompjuterike. Zhvillimi i këtij sektori ishte i dukshëm në Kosovë me kompanitë e reja që depërtojnë në treg. Ky sektor mund t'i ofrojë Kosovës mundësi të konsiderueshme që të diversifikojë eksportet e saj dhe të përmirësojë suficitin tregtar në veprimtaritë e shërbimeve. Tregtia e shërbimeve të informacionit paraqet një pjesë të vogël në këtë llogari, sepse kjo nën-kategori nuk është shumë e rëndësishme në rastin e Kosovës.

Duke e parë dinamizmin që TIK-u po e shfaq viteve të fundit, do të ishte shumë interesante të bëhej një analizë më e detajuar e këtij sektori.

Shërbimet Financiare

Sektori financiar luan një rol jetik në të gjitha ekonominë. Është praninë e shërbimeve financiare si ndërmjetëse që siguron shpërndarje të barabartë të fondeve në sektorët primar, sekondar dhe terciar dhe si rezultat sjell një rritje të balancuar të ekonomisë.⁹ Pjesa më e madhe e tregtisë së shërbimeve financiare të Kosovës zhvillohet përmes themelimit të bankave të huaja në Kosovë, gjë e cila nuk paraqitet në bilancin e pagesave dhe e cila duhet të vlerësohet si tregti e shërbimeve të filialeve të huaja (FATS)

Tabela 9. Shërbimet Financiare sipas nën-sektorëve									
Viti	Shërbimet shprehimisht të pagueshme dhe shërbimet tjera financiare			FISIM			Totali i Shërbimeve Financiare		
	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci	X	M	Bilanci
2017	0.8	5.2	-4.4	0.1	0.9	-0.8	0.9	6.1	-5.2
2018	0.9	9.1	-8.1	0.1	0.7	-0.6	1.1	9.8	-8.7
2019	0.4	5.2	-4.9	0.1	0.3	-0.2	0.5	5.6	-5.1


Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Në nivelin total, siç raportohet në bilancin e pagesave, tregtia e shërbimeve financiare është shumë e kufizuar. Eksportet totale kanë rënë nga EUR 900 mijë në vitin 2017 në EUR 500 mijë në vitin 2019. Nga ana e tyre, importet gjithashtu kanë rënë ndërmjet 2017 dhe 2019, megjithëse në një masë më të vogël dhe me luhajtje më të forta se eksportet. Në nivel më të zërthyer, shërbimet shprehimisht të pagueshme dhe shërbimet tjera financiare paraqesin pjesën dërrmuese të tregtisë në këto shërbime. Shërbimet shprehimisht të pagueshme dhe shërbimet tjera financiare përfshijnë të gjitha pagesat lidhur me shërbimet e ndërmjetësimit financiar dhe shërbimet ndihmëse, ku përfshihen shërbimet për provizionet dhe tarifën e shërbimeve të qiradhënies financiare, shërbimet për vlerësim të kredisë, transaksione të këmbimit valutor, shërbimet financiare rregullatorë dhe operative të tregut, shërbimet kreditore për klientë dhe biznese, linja kreditore, dokumentet për kredi dhe pagesat tjera, përfshirë tarifën e ripagimit të vonuar dhe tarifën e llogarisë. Në rastin e këtij nën-sektori, Kosova ka pësuar deficit tregtar gjatë periudhës së analizuar. Në vitin 2019, importet përfaqësuan 92 përqind të importeve totale në këtë llogari. Në rastin e shërbimeve ndërmjetëse financiare të vlerësuar tërthorazi (FISIM) të cilat përfshijnë kufijtë ndërmjet interesit të pagueshëm dhe normës referencuese për huadhënie dhe depozita, tregtia në këto shërbime është e pazhvilluar dhe nuk ka qenë veçanërisht dinamike gjatë kësaj periudhe, duke përfaqësuar vetëm një përqindje të vogël të tregtisë totale në shërbimet e përgjithshme financiare.

⁹ Eksportet përfshijnë shërbimet financiare të vlerësuara në mënyrë indirekte, të ofruara në aktivet e kredisë dhe detyrimet e depozitave të korporatave financiare rezidente, për të cilat pala është njësi jorezidente. Importet përfshijnë shërbimet financiare të vlerësuara në mënyrë indirekte, të blera nga njësitë rezidente nga të gjithë sektorët institucional me korporatat financiare jorezidente.

4.2.4 Shërbimet Qeveritare


Shërbimet qeveritare regjistrojnë shpenzimet e subjekteve të huaja diplomatike, të personelit ushtarak dhe stafit që gjenden jashtë shtetit dhe shpenzimet e ngjashme nga Kosova jashtë vendit. Ato përfshijnë gjithashtu shërbimet e ofruara nga dhe për qeveritë e përjashtuara nga çdo kategori tjetër shërbimesh. Figura 5 paraqet bilancin e pagesave për kategorinë 'mallrat dhe shërbimet qeveritare'. Gjatë periudhës së analizës, Kosova ka arritur të mbajë një suficit tregtar, edhe pse në një normë në rënie. Në rastin e eksporteve, ka pasur rënie në eksporte nga EUR 35.8 milion në vitin 2017 në EUR 32.8 milion në vitin 2019. Rënia e eksporteve mund t'i atribuohet uljes së pranisë dhe reduktimit të veprimtarive të subjekteve të huaja. Në anën tjetër, importet kanë pasur një rritje të qëndrueshme gjatë periudhës së njëjtë nga EUR 11.7 milion në vitin 2017 në EUR 22.7 milion në vitin 2019. Rritja në importe është pasqyrim i pranisë së shtuar të misioneve diplomatike të Kosovës dhe më shumë veprimtarive qeveritare në vendet e huaja.



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

4.2.5 Shërbimet personale, kulturore dhe rekreative

Kjo llogari shënon shpenzimet në shërbimet që lidhen me shërbimet audio-vizuale dhe artistike dhe shërbimet personale, kulturore dhe rekreative. Në rastin e Kosovës, nuk ka të dhëna për shërbimet audio-vizuale dhe shërbime të ngjashme. Në përgjithësi, Kosova ka përjetuar suficit tregtar për vitet për të cilat të dhënat ekzistojnë. Eksportet kulmore ishin në vitin 2019, me EUR 6.2 milion, ndërsa importet ishin EUR 4.7 milion. Nën-kategoria më e madhe në këtë llogari janë shërbimet personale, kulturore dhe rekreative.



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

5. Komentet Përmbyllëse

Ky raport, i cili është aktivitet vjetor i Ministrisë së Tregtisë, është punuar në bashkëpunim me Projektin e BE-s “Mbështetje e Mëtuqjeshme e Zhvillimit të Tregtisë në Kosovë”. Analiza e ndërmarrë tregon se veprimtaritë e shërbimeve kanë treguar dinamizëm viteve të fundit, edhe pse niveli i tanishëm i performancës nuk është aspak ashtu siç duhej të ishte. Veprimtaritë e shërbimeve të Kosovës mbeten akoma të ulëta në produktivitet dhe nuk ka artikulum të qartë midis sektorëve të prodhimit material dhe ofruesve të shërbimeve afariste vendore. Tregtia e shërbimeve të Kosovës varet kryesisht nga shërbimet e udhëtimit, të cilat nga ana e tyre lidhen ngushtë me udhëtimet hyrëse të diasporës për vizitë të familjeve dhe miqve, gjë e cila nuk paraqet turizmin në kuptimin e mirëfilltë. Varësia e madhe në shërbimet e udhëtimit ngrit pyetjen se sa i qëndrueshëm do të jetë ky model me kalimin e kohës.

Është nevojë urgjente që të përmirësohet mbledhja e të dhënave statistikore për veprimtaritë e shërbimeve, si në aspektin e llogarive kombëtare, duke gjeneruar të dhëna më të zërthyera në nivel sektorial, ashtu edhe në kategori të ndryshme të shërbimeve dhe në FATS. Mjetet ekzistuese statistikore dhe të informacionit duhet të avancohen në mënyrë që të mundësohet një analizë më e saktë e natyrës ndryshuese të tregtisë dhe politikave të shërbimeve. Zbatimi gradual i Doracakut të Statistikave (MSIT 2010) do të ishte mjet i duhur për të përmirësuar statistikën e tregtisë së shërbimeve.

Në fund, është nevojë e domosdoshme të hartohen dhe aprovohen rregulloret thelbësore të politikave për ta kthyer potencialin e tregtisë së shërbimeve në realitet, gjë që do të ndihmojë ndjeshëm në aspiratat zhvillimore të Kosovës. Si e tillë, një strategji për zhvillimin e tregtisë duhet të jetë shumë e rëndësishme në agjendën e qeverisë, e cila do të përfshijë si element kyç strategjinë e eksportit të shërbimeve. Ajo që nevojitet është një vlerësim i mëtejshëm gjithëpërfshirës sektorial, i cili do të mundësojë që vendimet e mirë informuara të politikave të krijojnë një strategji afatgjatë të rritjes së qëndrueshme.